

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

# STATUTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Prishtine, 28.02.2020

Në bazë të nenit 25 pika 3.2 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe pikës 3.1.2 të Doracakut të Auditimit të Brendshëm, Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nxjerr dhe dorëzon Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe komitetit të auditimit për miratim këtë:

## STATUT I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Qëllimi

Për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, me këtë statut përcaktohet autoriteti, përgjegjësia dhe struktura e brendshme e Njesisë së Auditimit të Brendshëm/ Drejtoria e Auditimit të brendshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

#### Neni 2 Fushëveprimi

Ky statut zbatohet nga Njësia e Auditimit të brendshëm/Drejtoria e Auditimit të brendshëm dhe njësitë tjera përkatëse të Kuvendit.  
Përmes këtij statuti janë definuar disa të drejta dhe përgjegjësi të përgjithshme të AB, të cilat janë paraparë me kornizën rregulative të AB në Republikën e Kosovës.

#### Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Statut, kanë kuptim:
  - 1.1 **Kryetar** – Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës
  - 1.2 **Kuvend** - Selia e aktivitetit zyrtar të Kryetarit, që përfshinë Kabinetin e Kryetarit, Zyren e Kryetarit dhe Institucionet/njësitë tjera të ndërlidhura;
  - 1.3 **NjAB/ DAB** – Njësia e Auditimit të Brendshëm në Kuvend/Drejtoria;
  - 1.4 **NjQH** – Njësia Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave dhe Transfereve
  - 1.5 **Ligj** – Ligji Nr. 061/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (GZ<sup>1</sup>, nr.3, 19 prill 2018);

---

<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare

- 1.6 **Rregullore** – Rregullorja QRK-Nr.01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik (miratuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.04/83, datë 11.01.2019);
  - 1.7 **Udhëzim** – Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik (11.02.2019)
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Statut kanë kuptimin e njëjtë sikurse në Ligj.

## **KAPITULLI II FUNKSIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

### **Neni 4**

#### **Funksioni i auditimit të brendshëm**

1. Kuvendi për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm ka Auditorin e brendshëm, i cili i raporton drejtpërdrejt Kryetares/it.
2. Struktura dhe numri i auditorëve të Njesisë së Auditimit të brendshëm/ Drejtorisë së Auditimit të brendshëm përcaktohet në pajtim me kriteret për zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm, duke u bazuar në nenin 5 të rregullores.

### **Neni 5**

#### **Funksioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm/Drejtorisë**

1. NjAB/DAB funksionin e auditimit të brendshëm në Kuvend, e ushtron në pajtim me Ligjin dhe rregulloren.
2. NjAB/DAB ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur, i raporton drejtpërdrejt Kryetarit dhe mbulon të gjitha njësitë e Kuvendit.
3. NjAB/DAB ka pavarësi funksionale për të planifikuar, kryer dhe raportuar për aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe nuk kryen detyra të tjera në kuadër të Kuvendit që nuk lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm.
4. Njësia e auditimit të brendshëm/ Drejtoria nuk ndikohet nga personat me autoritet nga brenda ose jashtë Kuvendit.
5. Auditorët e brendshëm gjatë kryerjes së auditimit, respektojnë legjislacionin e përgjithshëm në fuqi, kodin përkatës të etikës, kërkesat specifike të Ligjit, si dhe kërkesat relevante të publikuara nga NjQH në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Financa dhe transfere.
6. Drejtori i NjAB/DAB diskuton me Kryetarin (nëse ajo/ai nuk vendosë ndryshe) dhe KAB lidhur me Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, që të lehtësohet ndërmarrja e veprimeve efektive për korrigjim.
7. Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga Kryetari.
8. Të gjithë auditorët e NjAB/DAB marrin pjesë në trajnime dhe në zhvillim të vazhdueshëm profesional të nevojshëm për të mirëmbajtur, ruajtur certifikatën profesionale të auditimit të brendshëm, ndërsa Kryetarja/i siguron buxhet të mjaftueshëm për këtë qëllim.

## **KAPITULLI III AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSIA**

### **Neni 6 Autoriteti**

1. Njësia e Auditimit të Brendshëm/ Drejtoria, ka autoritet:
  - 1.1 Të ofroj shërbime të pavarura, objektive për Kryetaren/in lidhur me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
  - 1.2 Ndhmon Kuvendin që të arrij objektivat e tij duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes;
  - 1.3 Ushtron veprimtarinë e vetë në pajtim me Ligjin, rregulloren, udhëzimin dhe këtë Statut.
  - 1.4 Ofron këshilla për përmirësimin e kontrollit të brendshëm;
2. Në ushtrimin e autoritetit të vet, NjAB/DAB, të drejtat i kryen në pajtim me nenin 24 të Ligjit.

### **Neni 7 Përgjegjësia**

Drejtori i NjAB/DAB dhe Auditori i brendshëm ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në mënyrë objektive, profesionale, në përputhje me nenin 25 të Ligjit dhe metodologjinë e auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministri i Financave dhe transfereve.

### **Neni 8 Plani strategjik, vjetor dhe raportet e njësisë së auditimit të brendshëm/Drejtorisë**

1. Drejtori i NjAB/DAB përgatitë planin strategjik dhe vjetor, sipas modelit të dhënë në doracakun për auditim të brendshëm nga NjQH.
2. Kryetari dhe Komiteti i auditimit, e rishikojnë dhe miratojnë planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm. Pas miratimit të tyre, NjAB/DAB e dorëzon atë te NjQH, më së largu deri më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të vitit fiskal.
3. Pas përfundimit të çdo auditimi, raporti i dërgohet Kryetarit.
4. Drejtori i NjAB/DAB përgatitë raportin e gjashtëmujorit të parë dhe të dytë, si dhe raportin vjetor dhe dorëzon te Kryetari, KA dhe NjQH, më së largu deri më 15 (pesëmbëdhjetë) korrik të vitit dhe gjegjësisht deri më 15 (pesëmbëdhjetë) janar të vitit vijues.

### **Neni 9 Kufizimet e Konfliktit të Interesit**

Kufizimet në punën e auditorit të brendshëm dhe shmangies së konfliktit të interesit bëhet në pajtim me nenet 26 dhe 27 të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

**Neni 10**  
**Ndryshimet në Statut**

Drejtori i NjAB/DAB është përgjegjës për azhurnimin e Statutit të Auditimit të brendshëm në Kuvend.

Statuti mund të ndryshohet apo plotësohet vetëm në bazë të procedurave me të cilat është miratuar.

**KAPITULLI IV**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 11**  
**Bashkëpunimi me NjAB/DAB**


Të gjitha njësitë e Kuvendit obligohen, që të bashkëpunojnë dhe ti ofrojnë mbështetje NjAB/DAB, për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të tij.


**Neni 12**  
**Shfuqizimi**


Me hyrjen në fuqi të këtij Statutit shfuqizohet Statuti i Auditimit në Kuvendin e Kosovës i datës:27.03.2017.


**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Ky statut hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Kryetarja/i dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

  
\_\_\_\_\_  
Auditimi i brendshëm

  
\_\_\_\_\_  
Sekretari i Përgjithshëm

  
\_\_\_\_\_  
Kryesuesja e Komitetit të Auditimit

  
\_\_\_\_\_  
Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës